

VENDIM
Nr.12, datë 3.3.2009

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, të miratuar me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 3.3.2009, në kuadër të ushtrimit të autoritetit për zbatimin e metodologjive të vendosjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, pasi shqyrtoi kërkesën e METE-s nr.1930, datë 27.2.2009, si dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave, Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për miratimin e Deklaratës Rregullatore,

VENDOSI:

1. Miratimin e Deklaratës Rregullatore sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shfuqizimin e vendimit nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e Deklaratës Rregullatore”, të ndryshuar.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta